



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:126873
Datë: 26.02.2024
Numri i dokumentit: 05371622

Ac.nr.8020/2022

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Besnik Bislimaj, kryetar i kolegjit, Malsor Kryeziu dhe Hunaida Pasuli, anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditësit A. V. nga Gjilani, rr.“R. C.”, të cilin me autorizim bartës nga avokati E. P. e përfaqëson M. H. avokate në Viti, kundër të paditurës Ministria e Punëve të Brendshme (MPB), Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Kosovës me seli në Prishtinë, të cilën e përfaqëson i autorizuari M. K. avokat shtetëror në Ministrinë e Drejtësisë, me objekt kontestit kompensim i të ardhurave personale, duke vendosur sipas ankesës së të paditurës, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjilan, dega në Viti, Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.289/2019, datë 20.10.2022, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 23.02.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

HEDHET poshtë si e paafatshme ankesa e të paditurës Ministria e Punëve të Brendshme (MPB), Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Kosovës me seli në Prishtinë, e datës 15.11.2022, e parashtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjilan, dega në Viti, Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.289/2019, datë 20.10.2022.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e atakuar me numër C.nr.289/2019, datë 20.10.2022, gjykata e shkallës së parë ka vendosur: I. MIRATOHET në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditësit A. V. nga Gjilani, DETYROHET e paditura Ministria e Punëve të Brendshme – Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Kosovës me seli në Prishtinë, që paditësit për periudhën kohore prej 01.02.2017 deri me 07.03.2019, t'ia kompensojë të ardhurat mujore bruto në shumë të përgjithshme prej 13,255.84 euro, duke e llogaritur me kamatën ligjore prej 8%, nga data e ushtrimit të padisë më 13.06.2019,

e deri në pagesën përfundimtare, e gjithë kjo brenda afatit prej 7 ditësh pas plotfuqishmërinë së këtij aktgjykimi, nën pasojën e përmbarimit të dhunshëm. II. Detyrohet e paditura Ministria e Punëve të Brendshme – Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Kosovës me seli në Prishtinë, që t'ia kompensoj paditësit A. V. shpenzimet e procedurës në shumë prej 999 euro.

Kundër këtij aktgjykimi ankesë ka parashtruar e paditura, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimi të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që gjykata e shkallës së dytë ta aprovojë ankesën e të paditurës në tërësi si të bazuar ndërsa aktgjykimin e ankimuar ta ndryshojë ashtu që ta refuzojë në tërësi padinë e paditësit.

Me përgjigje në ankesë paditësi i ka kundërshtuar në tërësi pretendimet ankimore të të paditurës, me propozim që ankesa e të paditurës të hedhet poshtë si e palejuar apo në rast se ankesa nuk hudhet atëherë e njëjta të refuzohet si e pabazuar ndërsa aktgjykimi i ankimuar të vërtetohet.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195 dhe 200 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, ka vlerësuar se:

-Ankesa e të paditurës është e paafatshme.

Gjykata e Apelit të Kosovës, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, duke vlerësuar lejueshmërinë dhe afatshmërinë e ankesës së parashtruar nga pala e paditur, përkatësisht me shikimin në fletë kthesën për dorëzim personal, vërtetoi faktin se e paditura, aktgjykimin e atakuar të Gjykatës Themelore në Gjilan, dega në Viti, C.nr.289/2019, të datës 20.10.2022, e ka pranuar me datë 28.10.2022. Në anën tjetër, ankesa ndaj këtij aktgjykimi nga e paditura është dorëzuar në gjykatë me datë 15.11.2022 dhe atë përmes postës me datë 14.11.2022, datë kjo që shihet nga vula e pranimit të postës, e vendosur në zarfin e ankesës së të paditurës, ndërsa e njëjta është pranuar në gjykatën e shkallës së parë me datë 15.11.2022. Si rrjedhojë, pasi që afati për ankesë sipas dispozitës së nenit 477 të LPK-së, është 7 ditë nga dita e pranimit të aktgjykimin të shkallës së parë me të cilin është vendosur lidhur me kërkesëpadinë (kontest pune), atëherë rezulton që ankesa nga ana e të paditurës, është dorëzuar pas skadimit të afatit ligjor prej 7 ditësh.

Kjo për faktin se në këtë rast afati fillon të llogaritet nga data 29.10.2022, ndërsa kur llogariten 7 ditë, atëherë dita e fundit për parashtrimin e ankesës ka qenë data 04.11.2022 (ditë e premtë). Meqenëse pala e paditur ankesën e ka paraqitur në gjykatën e shkallës së parë dhe atë përmes postës me datë 14.11.2022, atëherë rezulton se ankesa është paraqitur pas skadimit të afatit ligjor.

Në bazë të nenit 186.1 të LPK-së parashihet se ankesën e paraqitur pas afatit të parashikuar me ligj, ankesën jo të plotë, apo ankesën e palejueshme e hedhë poshtë me aktvendim gjykata e shkallës së parë, pa caktuar fare seancë gjyqësore. Në bazë të cekurave dhe duke marrë për bazë se afati për ankesë është afat prekluziv, Gjykata e Apelit vendosi duke u bazuar në nenin 186 paragrafi 2, të LPK-së, sipas të cilit ankesa është e paafatshme po që se është paraqitur pas skadimit të afatit ligjor për paraqitjen e saj, si dhe nenit 196, të LPK-së, ku është përcaktuar se:

“ankesën e vonuar, jo të plotë, apo të palejueshme, e hedhë poshtë gjykata e shkallës së dytë me aktvendim, po që se nuk e ka bërë një gjë të tillë gjykata e shkallës së parë siç është parashikuar në (nenin 186)”, andaj pasi që në rastin konkret gjykata e shkallës së parë nuk e ka vlerësuar afatshmërinë e ankesës dhe të njëjtën nuk e ka hedhur si të pa afatshme, sipas ligjit vendosi gjykata e shkallës së dytë.

Nga sa u tha me lartë, Gjykata e Apelit e Kosovës në kuptim të dispozitës së nenit 195 par.1 pika a) dhe nenit 196 të LPK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

Ac.nr.8020/2022, datë 23.02.2024

Kryetari i kolegjit - gjyqtari,
Besnik Bislimaj